REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH
Njësia Org. / Org.Jedinica / Org Unit 01
Nr.Prot: / Broj Prot: / Prot.No: 05-441
Nr.i faqeve / Br.stranica / No.pages -9-
Data: / Datum: / Date: 26/01/2024
Prishtinë / a

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria-Vlada-Government***
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
**Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister**

**Nr/10/01/2024**
**Datë:25/01/2024**

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të Nenit 145 (pika 2) e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7, 01 Mars 2019), bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rregulloren (QRK) Nr.14/2023, për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Shtojca 1 paragrafi 6 nënparagrafi 6.1, lidhur me shkresën Nr. prot. 05-208, date 16.01.2024, nxjerrë:

**V E N D I M**

**I.** Miratohet Plani i Veprimit për zbatimin e Ligjit Nr. 08/L-200 Për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve Ngjitëse.

**II.** Shtojcë e këtij vendimi është Plani i Veprimit për zbatimin e Ligjit Nr. 08/L-200 Për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve Ngjitëse .

**III.** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Dr. Arben Vitia**
**Ministër i Shëndetësisë**

*Vendimi i dërgohet:*
- *Zavendësministrave;*
- *Sekretarit të përgjithshëm;*
- *IKSHPK;*
- *DZHSSH;*
- *Departamentit ligjor;*
- *Arkivit të MSh-së.*

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***
**Ministria e Shëndetësisë/Ministarstvo Zdravstva/Ministry of Health**

# PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.08/L-200 PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJEVE NGJITËSE

| Objektiva | Aktiviteti | Indikatori | Institucioni përgjegjës | Kosto | Afati |
|---|---|---|---|---|---|
| **Zbatimi dhe plotësimi i kornizës ligjore** | Rregullorja për përcaktimin e Procedurave për angazhimin dhe rekrutimin e kapaciteteve njerëzore plotësuese në rastet e emergjencës së shëndetit publik | Projekt Rregullorja e finalizuar e dorëzuar në Ministri | MSH, IKSHPK, SHSKUK, KPSH QEVERIA | Kosto administrative | 2024 |
| | Udhëzimi administrativ Ruajtja dhe mbrojtja e të dhënave personale | Projekt Udhëzimi i finalizuar i dorëzuar në Ministri | MSH, IKSHPK, | Kosto administrative | Q4, 2024 |

N0

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | për rastet e dyshimta, të mundshme dhe të konfirmuara nga sëmundjet ngjitëse dhe çështjet e veçanta shëndetësore | | ASHI, Agjensioni për mbrojtje të të dhënave | | |
| | Udhëzimi administrativ Kushtet për mënyrën e aplikimit të DDD-së kualifikimi profesional të punëtorëve, pajisje teknike dhe kushte të tjera | Projekt Udhëzimi i finalizuar i dorëzuar në Ministri | IKSHPK<br>MSH<br>QEVERIA | Kosto administrative | Q4, 2024 |
| | Udhëzimi administrativ<br>Llojet e ekzaminimeve mikrobiologjike që ofrohen sipas nivelit të kujdesit shëndetësor dhe kontrolli i sigurisë së cilësisë | Projekt Udhëzimi i finalizuar i dorëzuar në Ministri | IKSHPK<br>MSH | Kosto administrative | Q3, 2024 |
| | Udhëzimi administrativ<br>Kriteret, procedurat, masat e biosigurisë dhe biosigurimit për transportin e mostrave për qëllime diagnostike të sëmundjeve ngjitëse | Projekt Udhëzimi i finalizuar i dorëzuar në Ministri | IKSHPK<br>MSH | Kosto administrative | Q4, 2024 |
| | Udhëzimi administrativ<br>Masat dhe kushtet për | Projekt Udhëzimi i finalizuar i dorëzuar në Ministri | IKSHPK | Kosto administrative | Q2- Q4, 2024 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | sigurinë e pacientit, parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve në kujdesin shëndetësor dhe rezistenca antimikrobike | | MSH | | |
| | Plani i gatishmërisë dhe reagimit | Plani i gatishmërisë dhe reagimit i finalizuar dhe dorëzuar | MSH IKSHPK | | 2024 |
| | Plani operativ emergjent | Plani operativ i miratuar | MSH, IKSHPK | Kosto administrative | 2023 |
| | Planet kontingjente në varësi të emergjencës | Plani kontigjent i hartuar | MSH, IKSHPK, MBZHR, SHSKUK, QKUK | Kosto administrative | Në rast të situatës emergjente |
| **Fuqizimi i kapaciteteve dhe krijimi i institucioneve përkatëse** | Standarde, protokolle laboratorike për mostrat humane dhe realizon diagnostikën laboratorike të agjentëve infektivë me rëndësi për shëndetin publik | Standarde, protokolle laboratorike për mostrat humane dhe realizon diagnostikën laboratorike të agjentëve infektivë të zhvilluara dhe të aprovuara | IKSHPK | Kosto administrative | 2024-2026 |
| | Standarde, protokolle laboratorike për mostrat mjedisore | Standarde, protokolle laboratorike për mostrat mjedisore të zhvilluara dhe të aprovuara | IKSHPK/ Ekologji humane | Kosto administrative | 2023-2025 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Projekte kërkimore shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e shëndetit publik | Projekte kërkimore shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e shëndetit publik të zhvilluara | IKSHPK | Kosto administrative | 2024-2026 |
| | Themelimi i Qendrës Operative Emergjente brenda IKSHPK-së | Fuqizimi i QOEShP në IKShP dhe Themelimi i 6 Qendrave Operative Emergjente të Shëndetit Publik në QRShP | IKSHPK | 114,460.00 | (Plani i veprimit QOEShP) 2023-2025 |
| | Aktivizimi i Qendrës Operative Emergjente në SHSKUK | Qendra Operative Emergjente në SHSKUK e aktivizuar | SHSKUK, MSH | Kosto administrative | 2024 |
| | Themelimi i Komitetit për sëmundje ngjitëse | Komiteti i themeluar dhe funksional | Ministri i Shëndetësisë | Kosto administrative (vendim ministror) | Q4, 2023 |
| | Themelimi i Komitetit i inteligjencës epidemike | Komiteti i themeluar dhe funksional | Ministri i Shëndetësisë | Kosto administrative (vendim ministror) | Q4, 2023 |
| | Themelimi i Komitetit profesional për këshillim dhe imunizim | Komiteti i themeluar dhe funksional | Ministri i Shëndetësisë | Kosto administrative (vendim ministror) | Është i themeluar në 2022 |
| | Themelimi i Komitetit i kontrollit të rezistencës | Komiteti i themeluar dhe funksional | Ministri i Shëndetësisë | Kosto administrat ive (vendim | Emërtimi sipas ligjit Q4, 2023 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | antimikrobike | | | ministror) | Në kuadër të Grupit ndërsektorial për kontrollin e Rezistencës Antimikrobik ( GNKRA) Vendimi i sekretarit qershor 2023 |
| | Themelimi i Komitetit i kontrollit të infeksioneve gjatë kujdesit shëndetësor | Komiteti i themeluar dhe funksional | Ministri i Shëndetësisë | Kosto administrative (vendim ministror) | Emërtimi sipas ligjit Q4, 2023 Këshilli kosovar për parandalimin dhe kontrollin e Infeksioneve Spitalore |
| | Themelimi i Komitetit koordinues për kontrollin e HIV/AIDS | Komiteti i themeluar dhe funksional | Ministri i Shëndetësisë | Kosto administrative (vendim ministror) | Q4, 2023 |
| | Themelimi i Komitetit për hepatite virale | Komiteti i themeluar dhe funksional | Ministri i Shëndetësisë | Kosto administrative (vendim ministror) | Q1, 2024 |
| | Themelimi i Komitetit për shëndetin human, animal dhe mjedisor "Një shëndet" | Komiteti i themeluar dhe funksional | Qeveria (Ministri i Shëndetësisë) | Kosto administrative (vendim ministror) | Q1, 2024 |
| | Themelimi i Komitetit për tuberkuloz | Komiteti i themeluar dhe | Ministri i | Kosto administrative | Q4, 2023 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | funksional | Shëndetësisë | (vendim ministror) | |
| | Themelimi i Komitetit multisektorial për gatishmëri dhe reagim | Komiteti i themeluar në situata të qeta rol këshilldhënës dhe aktivizimi sipas emergjencës (rol vendimmarrës) | Qeveria<br>(me propozim të Ministri i Shëndetësisë) | Kosto administrative (vendim ministror) | Q4, 2023 |
| | Hartimi i Procedurave standarde operative të nxjerra për masat e veçanta për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse | Procedura standarde operative të nxjerra nga IKSHPK | MSH, IKSHPK, SHSKUK, Inspektorati sanitar dhe shëndetësor | Kosto administrative | 2024-2025 |
| | Themelimi i Laboratorëve referent mikrobiologjik të nivelit tretësor | Laboratoret referente të themeluara | MSH | Kosto administrative | 2024-2026 |
| | Zhvillimi i kontrollit të brendshëm të cilësisë së laboratorit mikrobiologjik | Proceduara standarde operative për Kontrollë të brendshëm të cilesise | Laboratoret mikrobiologjike publik dhe privat | Kosto administrative | 2024-2026 |
| | Zhvillimi i Kontrollit të jashtëm i cilësisë së laboratorit mikrobiologjik | Skema të zhvilluara për patogjen të caktuar | Laboratori referentë i Kosovës ose organizata profesionale ndërkombëtare përkatëse | 50,000.00 euro (kosto për pagesë për pjesëmarrje në kontrollë të jashtme të cilësisë) | 2024-2026 |
| | Hartimi i SOP për | SOP e hartuar | Inspektorati sanitar, | Kosto | 2024 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | menaxhimin e sigurtë të kufomës së të vdekurit nga sëmundjet ngjitëse me rrezikshmëri të lartë | | IKSHPK | administrative | |
| | Monitorimi i menaxhimit të procedurave të varrimit dhe zhvarrimit | SOP e hartuar | Inspektorati sanitar, Inspektorati shëndetësorë, Inspektorati komunal, Inpektorati i transportit, Policia e Kosovës | Kosto administrative | 2024 |
| **Mbikëqyrja epidemiologjike, kontrolli, sinjalizimi dhe raportimi:** | Zhvillimi dhe funksionalizimi i sistemit elektronik për mbikëqyrje të sëmundjeve ngjitëse | Sistemi elektronik funksional | MSH | Kosto administrative | 2024 |
| | Zhvillimi i Sistemit të integruar për zoonozat të mbikëqyrjes epidemiologjike humane, animale dhe mjedisore | Sistem i integruar "Një Shëndet " funksional | MSH, MBZHR, MMPHI | Kosto administrative | 2025-2026 |
| | Përgatitje e SOP për Organizimin e gatishmërisë 24/7 për mbikëqyrjen e sëmundjeve ngjitëse | SOP e hartuar | IKSHPK | | 2024 |
| | Përgatitje e SOP për Organizimin e kujdestarisë 24/7 për mbikëqyrjen e | SOP e hartuar | IKSHPK | | 2024 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | sëmundjeve ngjitëse | | | | |
| **Gatishmëria, reagimi në menaxhimin e Emergjencave të shëndetit publik** | Bashkëpunimi me Institucionet ndërkombëtare (OBSH, ECDC, CDC) në rast të Kërcënimeve serioze kombëtare dhe ndërkufitare për shëndetin | Raportet e ndërsjella, pjesëmarrja në takime, punëtori, konferenca, shkëmbimi i përvojave me institucionet ndërkombëtare | MSH<br>Donatorët | Kosto administrative | 2023-2025 |
| | Hartimi dhe aprovimi i protokolleve për paralajmërimin e hershëm, mbikëqyrjen, monitorimin, luftën ndaj kërcënimeve serioze ndërkufitare | Protokolle të hartuara | MSH<br>IKSHPK, Donatorët | Kosto administrative | 2024-2025 |
| | Emërimi i pikës së kontaktit për raportim të kërcënimeve ndërkufitare për sëmundje ngjitëse sipas Rregullores ndërkombëtare të shëndetit (IHR) | Pika e kontaktit e caktuar sipas Rregullores ndërkombëtare të shëndetit (IHR) | MSH | Kosto administrative | 2024 |
| | Zhvillimi i prokurimeve të përbashkëta për masat kundërepidemike, në përputhje me legjislacionin e BE-së në fuqi për kërcënime serioze ndërkufitare për shëndetin | Prokurime të përbashkëta të zhvilluara | MSH | Kosto administrative | 2024-2025 |